REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 343, Datë 06.11.2026
MBI

FILLIMIM E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E MODELIT TIP TË LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 18, 19 dhe 20, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*"; si dhe neneve 15 dhe 26 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s* miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 3501 prot., datë 05.11.2026, të përgatitur nga Grupi i Punës të ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 137, datë 18.08.2026 "*Mbi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin dhe miratimin modelit tip të Licencës për prodhimin e energjisë elektrike*",

Konstatoi se:

- Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", është përcaktuar një kuadër i ri ligjor për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, përfshirë veprimtarinë e prodhimit, si dhe për kompetencat e ERE-s në përcaktimin e rregullave dhe kërkesave për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave.
- Neni 20, pika 1, gërma "b" i ligjit nr. 59/2026, i njeh ERE-s të drejtën për të përcaktuar rregullat dhe kërkesat për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndërsa dispozitat e ligjit që rregullojnë licencimin përcaktojnë bazën për vendosjen e kushteve të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar.
- Modeli tip ekzistues i licencës për prodhimin e energjisë elektrike është hartuar në bazë të kuadrit ligjor të mëparshëm dhe kërkon rishikim për t'u harmonizuar me kërkesat dhe terminologjinë e ligjit nr. 59/2026, si dhe me aktet nënligjore që miratohen në zbatim të tij.
- Rishikimi i modelit tip synon të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të njëtrajtshme objektin dhe kufijtë e veprimtarisë së licencuar, të drejtat dhe detyrimet e prodhuesit, kërkesat për operimin teknik, mirëmbajtjen, raportimin, ruajtjen e dokumentacionit, kontrollin dhe monitorimin nga ERE, si dhe trajtimin e ndryshimeve që mund të ndikojnë në kushtet e licencës.
- Projekt-modeli parashikon një strukturë të riorganizuar të dokumentacionit shoqërues, me Aneksin A për identifikimin e impianteve dhe njësive gjeneruese, Aneksin Teknik për pasqyrimin e parametrave teknikë dhe kushteve të lidhjes, si dhe Aneksin B për kushtet e posaçme që mund të vendosen për të licencuarin, kur kjo justifikohet dhe mbështetet në bazën ligjore përkatëse.
- Ky dokument merr në konsideratë edhe rastet e depozitimit të integruar me impiantin e prodhimit, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 59/2026, duke bërë dallimin ndërmjet njësive të integruara të depozitimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së pavarur të depozitimit, e cila i nënshtrohet kërkesave përkatëse të licencimit.
- Gjatë hartimit të projektt-modelit janë shqyrtuar gjithashtu praktika rregullatore ndërkombëtare, përfshirë kushtet standarde të licencave të prodhimit të Ofgem dhe praktikat e autoriteteve të tjera rregullatore, me qëllim përmirësimin e strukturës dhe qartësisë së kushteve të licencës.

- Projekt-modeli së bashku me Anekset, do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga ERE për miratimin e akteve rregullatore, për të marrë komente dhe propozime përpara paraqitjes së tij për miratim përfundimtar nga bordi i ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për miratimin e modelit tip të Licencës për prodhimin e energjisë elektrike, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Projekt-modeli tip, së bashku me Aneksin A, Aneksin Teknik dhe Aneksin B, do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga ERE për miratimin e akteve rregullatore.

3. Ngarkohet Grupi i Punës për ndjekjen e procedurës, për kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale lidhur me publikimin dhe konsultimin e projektaktit, administrimin dhe shqyrtimin e komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura, si dhe organizimin e seancave dëgjimore, sipas nevojës, dhe përgatitjen e materialeve për vijimin e procedurës së miratimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s Nr. 343, Datë 06.11.2026

LICENCË
PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Numri i licencës	[●]
Seria	[●]
Data e vendimit të Bordit	[●]
Data e hyrjes në fuqi	[●]
Licenca i jepet	[Emri i plotë i personit juridik]
NUIS	[●]
Selia / adresa	[●]
Impianti/impiantet	Sipas Aneksit A
Kapaciteti i instaluar	[●] MW/MWp
Burimi primar / teknologjia	[●]
Detyrimi i shërbimit publik	[Nuk aplikohet / sipas kushteve të posaçme]
Kohëzgjatja	[●] vjet, por jo më shumë se 30 vjet

Në mbështetje të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe të vendimit të Bordit të ERE-s të identifikuar më sipër, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep subjektit të përcaktuar në këtë licencë të drejtën për të ushtruar veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në impiantet dhe me parametrat e përcaktuar në Aneksin A, në përputhje me vendimin e licencimit, kushtet e kësaj licence dhe legjislacionin në fuqi.

Kjo licencë hyn në fuqi në datën e përcaktuar në faqen e parë dhe është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në të, përveç rasteve të përfundimit ose heqjes së saj në përputhje me ligjin nr. 59/2026 dhe aktet nënligjore në fuqi.

KRYETARI I ERE-s

_____

KUSHTET E LICENCËS
PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Numri i licencës: [●]

Seria: [●]

I jepet: [Emri i plotë i të licencuarit]

NUIS: [●]

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Kjo licencë lëshohet nga ERE në ushtrim të kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe autorizon të licencuarin të ushtrojë vetëm veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike në impiantet dhe njësitë gjeneruese të identifikuara në Aneksin A.

1.2 Licenca përbëhet nga dokumenti kryesor, këto Kushte të Licencës, Aneksi A dhe çdo kusht i posaçëm i përcaktuar shprehimisht në vendimin e Bordit të ERE-s që miraton dhënien ose modifikimin e saj. Të gjitha këto pjesë përbëjnë një dokument të vetëm.

1.3 Në rast mospërputhjeje ndërmjet kushteve të kësaj licence dhe dispozitave detyruese të legjislacionit në fuqi, zbatohen dispozitat e legjislacionit. Kushtet e licencës interpretohen dhe zbatohen në përputhje me ligjin nr. 59/2026 dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

1.4 Termat e përdorur në këtë licencë kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 59/2026 dhe në aktet nënligjore përkatëse, përveç rasteve kur në këtë licencë përcaktohet shprehimisht ndryshe.

1.5 Kjo licencë nuk zëvendëson lejet, miratimet, autorizimet, pëlqimet, marrëveshjet e lidhjes në rrjet ose dokumentet e tjera që kërkohen nga legjislacioni në fuqi për ndërtimin, vënien në punë dhe operimin e impiantit.

1.6 Licenca nuk i jep të licencuarit të drejtën të ushtrojë veprimtari të tjera të licencuara në sektorin e energjisë elektrike, përveç rasteve kur subjekti është pajisur me licencën përkatëse ose përfiton nga një përjashtim i parashikuar shprehimisht në ligj.

1.7 Licenca është e vlefshme për personin juridik të identifikuar në faqen e parë dhe nuk mund të transferohet, të jepet në përdorim ose të disponohet në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 59/2026 dhe rregulloren përkatëse të ERE-s.

2. OBJEKTI DHE KUFIJTË E VEPRIMTARISË SË LICENCUAR

2.1 I licencuari autorizohet të prodhojë energji elektrike në impiantet dhe njësitë gjeneruese të përcaktuara në Aneksin A, në vendndodhjet, me burimet primare të energjisë, teknologjinë dhe kapacitetet e miratuara nga ERE.

2.2 Veprimtaria e licencuar ushtrohet brenda kufijve teknikë dhe operacionalë të impiantit, kushteve të lidhjes në rrjet, lejeve dhe autorizimeve përkatëse, si dhe kërkesave të kodeve të rrjetit dhe rregullave të tregut.

2.3 I licencuari nuk mund të ndryshojë vendndodhjen, burimin primar të energjisë, teknologjinë, konfigurimin kryesor ose parametrat e impiantit në mënyrë që të ndryshojë objektin apo kushtet e licencës, pa ndjekur procedurën përkatëse të miratimit ose modifikimit pranë ERE-s, kur kjo kërkohet nga legjislacioni.

2.4 Çdo ndryshim i kapacitetit të instaluar, kapacitetit të disponueshëm, numrit ose karakteristikave të njësive gjeneruese, si dhe çdo nxjerrje jashtë përdorimit apo zëvendësim i tyre, i njoftohet ERE-s dhe trajtohet sipas ligjit, rregulloreve dhe kushteve të kësaj licence.

2.5 Kur impianti përfshin ose do të përfshijë njësi depozitimi të energjisë të integruara me impiantin e prodhimit, të drejtat dhe kushtet e ushtrimit të këtij aktiviteti përcaktohen në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 59/2026 dhe pasqyrohen në Aneksin A ose në aneksin teknik të ndryshuar të licencës. Kjo dispozitë nuk përbën autorizim të përgjithshëm për ushtrimin e një veprimtarie të pavarur depozitimi.

2.6 Kohëzgjatja e licencës përcaktohet në vendimin e Bordit dhe nuk mund të tejkalojë kufirin maksimal prej 30 (tridhjetë) vjetësh, sipas nenit 41 të ligjit nr. 59/2026.

3. TË DREJTAT E TË LICENCUARIT

3.1 I licencuari ka të drejtë të përdorë burimet primare të energjisë në centralin e tij, në përputhje me teknologjinë e prodhimit, karakteristikat teknike, kushtet e licencës dhe legjislacionin në fuqi.

3.2 I licencuari ka të drejtë të shesë energjinë elektrike të prodhuar dhe të marrë pjesë në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e tregut, kodet e rrjetit dhe detyrimet e regjistrimit e të balancimit që zbatohen për të.

3.3 I licencuari ka të drejtë të sigurojë shërbime ndihmëse dhe shërbime balancuese, kur plotëson kushtet teknike dhe tregtare të përcaktuara në legjislacionin dhe rregullat përkatëse.

3.4 I licencuari ka të drejtë të ketë akses në rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, sipas pikës së lidhjes dhe kushteve të miratuara, kundrejt pagesës së tarifave përkatëse dhe në përputhje me kodet e rrjetit.

3.5 Të drejtat e përcaktuara në këtë seksion ushtrohen pa cenuar detyrimet e të licencuarit ndaj operatorit të sistemit, operatorit të tregut, pjesëmarrësve të tjerë të tregut dhe ERE-s.

4. DETYRIMET E TË LICENCUARIT

4.1 Përputhshmëria ligjore dhe rregullatore

4.1.1 I licencuari ushtron veprimtarinë në përputhje me ligjin nr. 59/2026, këtë licencë, aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, kodet e rrjetit, rregullat e tregut dhe vendimet e ERE-s që janë të zbatueshme për veprimtarinë e tij.

4.1.2 I licencuari zbaton urdhrat, udhëzimet dhe instruksionet operative të operatorit të sistemit, të lëshuara në përputhje me legjislacionin dhe kodet përkatëse.

4.1.3 I licencuari siguron që veprimtaria e prodhimit të kryhet vetëm në impiantet dhe njësitë e autorizuara dhe nuk pengon aksesin e ligjshëm të pjesëmarrësve të tjerë të tregut në rrjet ose konkurrencën në treg.

4.2 Siguria operative dhe mirëmbajtja

4.2.1 I licencuari mban impiantet, pajisjet dhe sistemet ndihmëse në gjendje të sigurt dhe të përshtatshme për operim, në përputhje me projektin e miratuar, standardet teknike, kërkesat e prodhuesit dhe legjislacionin në fuqi.

4.2.2 I licencuari zbaton programet e mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese, kryen kontrollet dhe provat teknike të nevojshme dhe mban dokumentacionin përkatës të disponueshëm për ERE-n dhe autoritetet kompetente.

4.2.3 I licencuari merr masat e nevojshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, sigurinë e pasurisë, parandalimin e zjarrit dhe menaxhimin e situatave emergjente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.2.4 I licencuari njofton menjëherë operatorin e sistemit dhe ERE-n, sipas rastit, për çdo ngjarje, defekt ose situatë që rrezikon ose mund të rrezikojë sigurinë e furnizimit, sigurinë e sistemit, personat, mjedisin ose përmbushjen e detyrimeve të tij kontraktore dhe rregullatore.

4.3 Operimi, dispeçerimi dhe balancimi

4.3.1 I licencuari siguron komunikim dhe shkëmbim të të dhënave operative me operatorin e sistemit në kohë dhe në formatin e kërkuar nga kodet e rrjetit dhe procedurat operative.

4.3.2 I licencuari respekton udhëzimet e dispeçerimit, kufizimet operative dhe urdhrat e operatorit të sistemit, të dhëna në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.3.3 I licencuari përmbush përgjegjësitë që lidhen me parashikimin, nominimin, matjen, raportimin dhe shlyerjen e disbalancave, sipas rolit të tij në treg dhe rregullave të zbatueshme.

4.3.4 I licencuari siguron instalimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të matjes, telekomunikimit, telemetrisë dhe kontrollit që kërkohen nga kodi i rrjetit, marrëveshja e lidhjes dhe operatori i sistemit.

4.4 Mjedisi dhe eficienca

4.4.1 I licencuari ushtron veprimtarinë në përputhje me lejet mjedisore dhe kushtet e tyre, legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe detyrimet për menaxhimin e mbetjeve, ujërave, emetimeve dhe ndikimeve të tjera mjedisore, sipas teknologjisë së përdorur.

4.4.2 I licencuari njofton ERE-n për çdo masë administrative, pezullim, ndryshim ose revokim të lejeve mjedisore që mund të ndikojë në ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.

4.4.3 I licencuari merr masa të arsyeshme për përdorimin eficient të burimeve dhe energjisë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe kushtet e impiantit.

4.5 Regjistrimi në treg dhe marrëdhëniet me operatorët

4.5.1 I licencuari kryen regjistrimin përkatës si pjesëmarrës në treg dhe përmbush kërkesat e operatorit të tregut, operatorit të sistemit dhe strukturave të tjera përkatëse, sipas rregullave të tregut.

4.5.2 I licencuari lidh dhe mban në fuqi marrëveshjet e nevojshme për lidhjen në rrjet, përdorimin e rrjetit, matjen, balancimin dhe shërbimet përkatëse, sipas rastit.

4.6 Detyrimi i shërbimit publik

4.6.1 Kur me vendim të ERE-s të licencuarit i vendoset detyrim i shërbimit publik, ky detyrim përfshihet në kushtet e posaçme të licencës dhe zbatohet në përputhje me nenin 49 të ligjit nr. 59/2026 dhe aktet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

4.6.2 Kushtet e posaçme përcaktojnë, sipas rastit, natyrën, objektin, kohëzgjatjen, zonën, përfituesit, mënyrën e përmbushjes dhe mekanizmin e kompensimit të detyrimit të shërbimit publik. Në mungesë të një detyrimi të tillë, kjo pikë nuk krijon detyrim të pavarur për të licencuarin.

4.7 Njoftimet dhe ndryshimet në të dhënat e të licencuarit

4.7.1 I licencuari njofton ERE-n, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të ndryshimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ose nga data e ndodhjes së tij, sipas rastit, për çdo ndryshim në emërtimin tregtar, selinë, adresën e komunikimit, të dhënat e kontaktit, përfaqësuesit ligjorë, administratorët dhe të dhënat e tjera identifikuese të shoqërisë, duke paraqitur dokumentacionin justifikues përkatës.

4.7.2 Ndryshimet që lidhen me statusit ligjor, strukturën e pronësisë ose kontrollin e të licencuarit trajtohen në përputhje me kërkesat për autorizim të ERE-s, sipas ligjit nr. 59/2026 dhe rregullores përkatëse, dhe nuk i nënshtrohen vetëm detyrimit të njoftimit të parashikuar në pikën 4.7.1.

4.7.3 Njoftimi i ERE-s sipas pikës 4.7.1 nuk përbën miratim të ndryshimeve dhe nuk zëvendëson autorizimin paraprak të ERE-s në rastet kur ky autorizim kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

4.7.4 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i ushtrimit të veprimtarisë, i licencuari do të depozitojë në ERE dokumentacionin e testimit të veprës.

4.8 Pagesat rregullatore

4.8.1 I licencuari paguan pagesat rregullatore ndaj ERE-s në masën, mënyrën e përcaktuara nga legjislacioni dhe vendimet përkatëse të ERE-s.

5. LLOGARITË, RAPORTIMI DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE

5.1 I licencuari mban regjistrat dhe dokumentacionin financiar, kontabël, teknik dhe operacional të veprimtarisë së licencuar, në përputhje me sistemin e njësuar dhe standardet e llogarive të miratuara nga ERE, kur janë të zbatueshme, si dhe me legjislacionin në fuqi.

5.2 I licencuari përgatit pasqyrat financiare vjetore dhe i nënshtrohet auditimit të pavarur në përputhje me legjislacionin në fuqi. Raportimi financiar pranë ERE-s kryhet sipas sistemit dhe formateve të përcaktuara në zbatim të neneve 47 dhe 48 të ligjit nr. 59/2026.

5.3 I licencuari mban të dhëna të sakta dhe të verifikueshme për energjinë e prodhuar, energjinë e injektuar në rrjet, konsumin vetjak, disponueshmërinë e njësive, ndërprerjet, defektet, kufizimet e prodhimit, mirëmbajtjen dhe çdo tregues tjetër që kërkohet nga ERE ose operatori i sistemit.

5.4 I licencuari i paraqet ERE-s informacionin dhe raportet periodike sipas afateve të mëposhtme:

a) Raportin mujor të aktivitetit, brenda datës 15 të muajit pasardhës, i cili përmban të dhënat mbi sasinë e energjisë elektrike të prodhuar dhe të injektuar në rrjet, orët e operimit, disponueshmërinë e njësive gjeneruese, ndërprerjet, kufizimet e prodhimit dhe problematikat e evidentuara gjatë muajit;

b) Raportin vjetor të aktivitetit, brenda datës 31 janar të vitit pasardhës, i cili përmban analizën e veprimtarisë së të licencuarit gjatë vitit paraardhës, prodhimin vjetor të energjisë elektrike, treguesit e disponueshmërisë dhe cilësisë së operimit, defektet e ndodhura, masat e mirëmbajtjes, si dhe ndryshimet e kryera në asetet e prodhimit, përfshirë zgjerimin, zëvendësimin ose nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre;

c) Pasqyrat financiare vjetore dhe dokumentacionin e auditimit, kur ky i fundit kërkohet nga legjislacioni në fuqi, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin përkatës dhe në aktet rregullatore të ERE-s.

5.5. Informacioni dhe dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ERE gjatë ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore dhe mbikëqyrëse paraqitet brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës, përveç rasteve kur ERE përcakton një afat tjetër, në varësi të natyrës dhe urgjencës së informacionit të kërkuar.

5.6. Në rastet e ngjarjeve që ndikojnë në sigurinë e sistemit, sigurinë e operimit të impiantit ose vazhdimësinë e veprimtarisë së licencuar, i licencuari njofton menjëherë ERE-n dhe operatorin përkatës të sistemit, duke paraqitur informacionin paraprak dhe masat e marra për adresimin e situatës.

5.7 I licencuari ruan konfidencialitetin e informacionit financiar, tregtar dhe teknik që lidhet me veprimtarinë e tij të licencuar, përfshirë kontratat e shitblerjes së energjisë elektrike, kushtet tregtare të marrëveshjeve me palët e treta, strukturën e kostove, dokumentacionin teknik të impiantit dhe informacionin mbi sistemet e kontrollit dhe sigurisë, në rastet kur ky informacion përbën sekret tregtar ose mbrohet nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion nuk mund t'u bëhet i ditur personave të tretë pa autorizimin përkatës, përveç rasteve kur paraqitja ose publikimi i tij kërkohet nga ERE ose nga autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. KONTROLLI DHE MONITORIMI NGA ERE

6.1 ERE monitoron përmbushjen e kushteve të kësaj licence dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi nga i licencuari, në ushtrim të kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 59/2026.

6.2 Për qëllime të monitorimit, ERE ka të drejtë të kërkojë informacion, dokumentacion, të dhëna teknike, operative dhe financiare, të kryejë inspektime dhe hetime, si dhe të ushtrojë akses në llogaritë e të licencuarit, në masën e nevojshme për kryerjen e funksioneve të saj rregullatore dhe mbikëqyrëse.

6.3 I licencuari bashkëpunon me ERE-n, siguron aksesin e përfaqësuesve të autorizuar në objektet dhe dokumentacionin përkatës dhe paraqet informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e ERE-s.

6.4 ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të marrë gjatë ushtrimit të kompetencave të saj, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 59/2026 dhe legjislacionin në fuqi.

6.5 Në rast konstatimi të shkeljeve, ERE vepron sipas kompetencave dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 59/2026, legjislacionin për procedurat administrative dhe aktet nënligjore përkatëse, duke garantuar të drejtën e të licencuarit për t'u dëgjuar.

6.6 Masat administrative, përfshirë gjobat, vendosen vetëm në rastet, sipas kritereve dhe në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

7. MODIFIKIMI I LICENCËS

7.1 Licenca mund të modifikohet me kërkesë të të licencuarit ose me iniciativë të ERE-s, në rastet dhe sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 59/2026 dhe rregulloren përkatëse të licencimit.

7.2 Kërkesa për modifikim shoqërohet me dokumentacionin që justifikon ndryshimin e kërkuar, përfshirë, sipas rastit, dokumentacionin teknik, lejet dhe autorizimet, marrëveshjet e lidhjes, të dhënat financiare dhe çdo dokument tjetër të kërkuar nga ERE.

7.3 Modifikimi i licencës miratohet me vendim të Bordit të ERE-s dhe pasqyrohet në licencë ose në aneksin përkatës. Deri në hyrjen në fuqi të modifikimit, i licencuari vijon të zbatojë kushtet ekzistuese të licencës.

7.4 Ndryshimet që lidhen me zëvendësimin e pajisjeve ndihmëse, elementeve të sistemit të kontrollit, mbrojtjes, matjes dhe monitorimit të impiantit, si dhe ndërhyrjet teknike për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e funksionimit të tij, të cilat nuk sjellin ndryshim të kapacitetit të instaluar, burimit primar të energjisë, teknologjisë së prodhimit, vendndodhjes, pikës së lidhjes në rrjet apo karakteristikave kryesore të njësive gjeneruese të miratuara në Aneksin A, nuk kërkojnë modifikimin e licencës. I licencuari njofton ERE-n për këto ndryshime brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga realizimi i tyre, duke paraqitur një përshkrim të ndërhyrjes, dokumentacionin teknik të pajisjeve të zëvendësuara ose të instaluara dhe, kur kërkohet, miratimet përkatëse të operatorit të sistemit.

8. TRANSFERIMI I LICENCËS DHE I ASETEVE

8.1 Transferimi i licencës ose i aseteve të të licencuarit që shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar kryhet me miratimin paraprak të ERE-s, në rastet dhe sipas procedurave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit nr. 59/2026 dhe rregulloret përkatëse të ERE-s.

8.2 I licencuari nuk mund të kryejë veprime juridike që sjellin transferimin ose disponimin e aseteve të lidhura me veprimtarinë e licencuar, kur për këto veprime kërkohet miratim paraprak i ERE-s, pa marrë më parë miratimin përkatës.

8.3 Përjashtimet nga detyrimi për miratim paraprak zbatohen vetëm në rastet dhe sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e ERE-s për transferimin e aseteve.

8.4 Transferimi i licencës ose i aseteve nuk cenon detyrimet e të licencuarit që rrjedhin nga kjo licencë deri në momentin kur transferimi dhe çdo ndryshim përkatës prodhojnë efektet juridike sipas vendimit të ERE-s.

9. HEQJA DHE PËRFUNDIMI I LICENCËS

9.1 Heqja e licencës kryhet në rastet dhe sipas procedurave të përcaktuara në nenin 45 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe në Rregulloren e ERE-s për Procedurat e Heqjes së Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike.

9.2 Përfundimi i licencës për shkak të mbarimit të afatit të vlefshmërisë ose në raste të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi nuk e përjashton të licencuarin nga përmbushja e detyrimeve të lindura gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj.

9.3 Heqja e licencës mund të kryhet edhe me kërkesë të të licencuarit, i cili paraqet pranë ERE-s kërkesën përkatëse, të shoqëruar me arsyetimin për ndërprerjen e ushtrimit të veprimtarisë së licencuar dhe dokumentacionin justifikues. Kërkesa shqyrtohet nga ERE në përputhje me procedurën e përcaktuar në Rregulloren për Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike.

9.4 Përfundimi i licencës nuk cenon përgjegjësinë e të licencuarit për detyrimet, shkeljet ose pasojat e krijuara gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj.

10. FORCA MADHORE

10.1 Asnjëra palë nuk mban përgjegjësi për mospërmbushjen e një detyrimi të kësaj licence kur kjo mospërmbushje shkaktohet drejtpërdrejt nga një ngjarje e forcës madhore, sipas përkufizimit të ligjit nr. 59/2026, me kusht që pala e prekur të ketë marrë masat e arsyeshme për të parandaluar ose kufizuar pasojat.

10.2 I licencuari njofton pa vonesë, por jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga momenti i ndodhjes së ngjarjes ose marrjes dijeni për të, ERE-n dhe operatorin përkatës të sistemit për çdo ngjarje të forcës madhore që ndikon në ushtrimin e veprimtarisë së licencuar. Njoftimi duhet të përmbajë përshkrimin e ngjarjes, natyrën dhe kohëzgjatjen e pritshme të saj, ndikimin në kapacitetin prodhues dhe në operimin e impiantit, si dhe masat e marra për kufizimin e pasojave dhe rikthimin e operimit normal.

10.3 Ngjarja e forcës madhore nuk e përjashton të licencuarin nga detyrimet e njoftimit, bashkëpunimit dhe marrjes së masave për sigurinë e njerëzve, pasurisë, mjedisit dhe sistemit elektroenergjetik.

11. NJOFTIMET DHE KOMUNIKIMI

11.1. Çdo njoftim, kërkesë, informacion apo dokumentacion që i drejtohet ERE-s nga i licencuari paraqitet në protokollin e ERE-s, nëpërmjet shërbimit postar ose në adresën zyrtare elektronike të institucionit, sipas mënyrave të pranuara nga ERE.

11.2. Njoftimet dhe komunikimet e ERE-s drejtuar të licencuarit kryhen në adresën e selisë së regjistruar të shoqërisë ose në adresën elektronike zyrtare të deklaruar prej tij pranë ERE-s, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurave Administrative.

11.3. Për efekt të komunikimit, njoftimet me postë konsiderohen të kryera sipas afateve të përcaktuara në nenin 155 të ligjit nr. 44/2015, ndërsa njoftimet elektronike sipas nenit 156 të këtij ligji. Dorëzimi personal i dokumentacionit vërtetohet me konfirmimin përkatës të marrjes.

12. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE E DREJTA E ANKIMIT

12.1 ERE shqyrton dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet pjesëmarrësve në sektorin e energjisë elektrike, në rastet dhe brenda kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

12.2. Shqyrtimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve kryhet sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke garantuar të drejtën e palëve për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur pretendimet dhe provat përkatëse.

12.3 Vendimet e Bordit të ERE-s ankimohen në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

13. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

13.1 Kjo licencë dhe anekset e saj përbëjnë tërësinë e kushteve të autorizimit të të licencuarit për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

13.2 Çdo ndryshim ose shtesë në këtë licencë bëhet në përputhje me ligjin nr. 59/2026 dhe procedurat e miratuara nga ERE.

13.3 Kjo licencë hyn në fuqi në datën e përcaktuar në dokumentin kryesor dhe është e detyrueshme për të licencuarin gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.

ANEKSI A

LISTA E AUTORIZUAR E IMPIANTEVE DHE NJËSIVE GJENERUESE

Ky aneks është pjesë përbërëse e Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike me nr. [●], seri [●], dhënë shoqërisë [●].

Nr.	**Emërtimi i impiantit**	**Vendndodhja (adresa/koordinatat)**	**Burimi primar / teknologjia**	**Njësia gjeneruese**	**Kapaciteti i instaluar (MW/MWp)**	**Data e vënies në punë**
[●]	[●]	[●]	[●]	[●]	[●]	[●]
[●]	[●]	[●]	[●]	[●]	[●]	[●]
[●]	[●]	[●]	[●]	[●]	[●]	[●]
[●]	[●]	[●]	[●]	[●]	[●]	[●]

Shënim: Për impiantet hibride ose ato që përfshijnë njësi depozitimi, të dhënat përkatëse teknike, përfshirë fuqinë në MW, kapacitetin energjetik në MWh, mënyrën e lidhjes dhe konfigurimin e operimit, pasqyrohen në tabelë ose në shtojcen teknike vijuese, sipas vendimit të ERE-s.

Data e hyrjes në fuqi të Aneksit A: [●]

KRYETARI I ERE-s

_____

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

ANEKSI TEKNIK I ANEKSIT A
TË DHËNAT TEKNIKE TË IMPIANTIT DHE NJËSIVE GJENERUESE

Ky Aneks Teknik është pjesë përbërëse e Aneksit A të Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike nr. [●], seri [●], dhënë shoqërisë [●], me NUIS [●].

IIV. LIDHJA ME RRJETIN

Operatori i sistemit	[OST sh.a./OSSH sh.a./tjetër]
Niveli i tensionit të lidhjes	[●] kV
Dokumenti i miratimit të lidhjes	[Nr./datë dhe palët]

V. KARAKTERISTIKAT TEKNIKE SIPAS LLOJIT Të BURIMIT Të ENERGJISë

Plotësohen vetëm të dhënat që lidhen me teknologjinë konkrete dhe që rezultojnë në projektin teknik, dokumentacionin e miratuar ose aktet e kolaudimit.

Lloji I burimit të energjisë	
Fotovoltaike	
Eolike	
Hidrike	
Termike/biomasë/gaz	
Tjetër	

VII. NJËSITË E DEPOZITIMIT TË INTEGRUARA (KUR APLIKOHET)

Plotësohet vetëm kur impianti përfshin njësi depozitimi të integruara dhe integrimi është trajtuar në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 59/2026. Kjo pjesë nuk përbën autorizim për ushtrimin e veprimtarisë së pavarur të depozitimit.

Teknologjia e depozitimit	[●]
Fuqia nominale e karikimit	[●] MW
Fuqia nominale e shkarkimit	[●] MW
Kapaciteti energjetik	[●] MWh
Numri dhe konfigurimi i njësive/modulëve	[●]
Mënyra e lidhjes me impiantin dhe rrjetin	[AC-coupled/DC-coupled/konfigurim tjetër]
Pika e lidhjes dhe kufiri i injektimit	[●]

1. Të dhënat e këtij Aneksi Teknik pasqyrojnë karakteristikat e impiantit dhe njësive gjeneruese të autorizuara me licencë, bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur dhe të vlerësuar në procedurën e licencimit ose modifikimit të licencës.

2. Aneksi Teknik lexohet së bashku me Aneksin A dhe kushtet e licencës. Në rast mospërputhjeje, zbatohen vendimi i Bordit të ERE-s dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi.
3. Fushat që nuk zbatohen shënohen "Nuk aplikohet". Nuk plotësohen të dhëna të supozuara ose parametra që nuk rezultojnë nga dokumentacioni teknik i miratuar.

Data: [●]

KRYETARI I ERE-s

_____

ANEKSI B
KUSHTE TË POSAÇME TË LICENCËS

Ky aneks plotësohet vetëm kur vendimi i Bordit të ERE-s vendos kushte individuale për të licencuarin, të cilat nuk zbatohen në mënyrë të njëjtë për të gjithë mbajtësit e licencës.

Detyrimi i shërbimit publik (nëse aplikohet): *[përshkrimi i detyrimit, afati, zona dhe kushtet e përmbushjes]*.